



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.0802-112
13.03.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.0803-61 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin me nr.ark.0201-1153/4 datë 12.03.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 9-të mbajtur më 12.03.2024 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio, mbaron (pushon) së vlefshmi me Ligj, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni i cituar i Ligjit, Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ka pushuar së vlefshmi në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.0201-1054/2 datë 01.03.2024, miratoi Vendim PA1 nr.0803-61 datë 04.03.2024, me të cilën i hiqet leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023, për shkak se zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar me ligj prej - 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës me nr.2024-100-0038 datë 11.01.2024. (nr ynë.ark.0503-201/1 datë 11.01.2024).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dhe në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.0803-61 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin me nr.ark.0201-1153/4 datë 12.03.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 9-të mbajtur më 12.03.2024, miratoi vendim si në dipozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.